



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
Bordi i Administrimit

Nr. 3349 Prot

Shkodër, me 13.10 2025

V E N D I M

Nr. 262 datë 13.10 2025

**PËR NJË NDRYSHIM TË VENDIMIT NR.74 DATË 10.03.2023 "PËR MIRATIM TË
TARIFËS VJETORE TË SHKOLLIMIT NË PROGRAMIN E STUDIMIT TË
CIKLIT TË TRETË, DOKTORATË PËR STAFIN AKADEMIK ME KOHË TË
PLOTË "**

Në mbështetje të Ligjit të AL me nr.80/2015 datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni 3, pika 3, germa c; neni 95, neni 98, pika 3; neni 108, pika 4; Ligjit nr.44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë"; VKM nr.75 datë 12.02.2018 "Për miratimin e modelit të financimit të Institucioneve Publike të AL", IV; Vendimit nr.879 datë 18.12.2019 për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.41 datë 24.01.2018, të Këshillit të Ministrave "Për elementet e programeve të studimit të ofruara nga IAL" pika 2.12, germa a; Statutin e USH-së neni 5, pika 3; neni 17; neni 56 pika 3, neni 58 pika 4; me vendimin e Senatit Akademik nr.252 datë 30.09.2025, Bordi i Administrimit me vendim qarkullues të datës 13.10.2025

Vendosi:

1. Miratimin e një ndryshimi në pikën 1 të vendimit të BA-së, nr.74 datë 10.03.2023 "Për miratimin e tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit të ciklit të tretë, Doktoratë, për stafin akademik me kohë të plotë" si vijon:

Ishte: Miratimin e mbulimit të tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit "Doktoratë", për stafin akademik me kohë të plotë.

Bëhet: Miratimin e mbulimit të tarifës vjetore të shkollimit në programin e studimit "Doktoratë", për stafin akademik me kohë të plotë, vetëm për kohëzgjatjen normale të programit të studimit, që i referohet periudhës 3(tre) vite akademike, me përjashtim të rrethanave objektive të justifikuara me dokumentacionin provues si dhe për shkak të forcave madhore.

2. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetari i Bordit të Administrimit

Prof. Asoc. Dr. Adrián LEKA

